



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut
Opština Istok
Istog Municipality

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

12 Nr 05/2026
24.02.2026

Komuna Istog, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, në bazë të Rregullores Komunale Nr.146/2025 për ndarjen e Subvencioneve si dhe në bazë të rregullores së Ministrisë së Financave Nr. 04/2017 për kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve shpallë:

Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare për projektet/programet e OJQ-ve në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

- 1.** Komuna e Istogut fton të gjitha organizatat jo-qeveritare të cilat veprojnë në Komunën e Istogut, programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në zhvillimin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
- 2.** OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektet/programet e tyre për aktivitetet e mëposhtme:

- **SEKTORI I KULTURËS**

1. Aktivitete kulturore-artistike
2. Manifestime kulturore për data të veqanta shtetërore
2. Fuqizimi i artistëve të rinj.

- **SEKTORI I SPORTIT DHE RINISË**

1. Përkrahja e Klubeve Sportive në gara zyrtare vendore.
2. Aktivitete rekreative dhe Sportive për nder të datave të veqanta.
3. Aktivitete për personat me aftësi të kufizuara
4. Organizime të turnireve në sport
5. Fuqizimi i rinisë.

3. Dokumentet kryesore të cilat duhet të dorëzohen nga OJQ-të përfshijnë:

1. Certifikata e regjistrimit të OJQ-së.
2. Certifikata e nr. Fiscal.
3. Vërtetimin/konfirmimin e llogarisë bankare të lëshuar nga banka përkatëse (nuk pranohet kopje e kartelës bankare).
4. Kopjen e letërnjoftimit të drejtuesit të OJQ-së apo dokument tjetër identifikues valid.
5. Vërtetimin nga ATK, që dëshmon se OJQ-ja nuk ka obligime tatimore.
6. Vërtetimin nga gjykata që ojq-ja nuk është në procedura të shuarjes dhe ç' regjistrimit. (pas shpalljes të rezultateve, për OJQ-të përfituese të thirrjes në fjalë)
7. Aplikacionet :
 - -Formulari i Aplikacionit për Projekt/program,
 - -Formulari i Propozim Buxhetit,
 - -Formulari i Deklaratës për Financimit të Dyfishtë,
 - -Formulari i Deklaratës së Partneritetit, (opcionale - nëse ka partneritet),
 - -Formulari i deklarimit të projekteve të financuara nga burimet publike

4. KRITERET PËR PJESËMARRJE NË THIRRIEN PUBLIKE PËR SUBVENCION, SI DHE KRITERET E PRANUESHME

1. Të drejtë aplikimi kanë OJQ-të, të cilat janë të regjistruara në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Komunën e Istogut së paku një vit para datës së publikimit të thirrjes publike;
2. OJQ-të, aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar dhe kanë përvojë në fushën për të cilën aplikojnë në Kulturë, në Rini apo në Sport.
3. OJQ-të, mund të subvencionohen vetëm një herë brenda vitit për të njëjtin aktivitet.

4. OJQ-të, të cilët nuk kanë përmbyllë raportin e subvencioneve të viteve paraprake nuk kanë të drejtë të përfitojnë nga subvencionet e Komunës së Istogut në këtë thirrje.
5. Të mos kenë pranuar mjete nga burime të tjera të financimit për të njëjtat aktivitete brenda të njëjtit vit fiscal.
6. Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, sic parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.
7. Organizatat jo-qeveritare mund të aplikojnë vetëm me nga një projekt në kuadër të Kulturës, Rinisë dhe Sportit i cili do të përfshijë dhe kontribojë në promovimin e aktiviteteve të paraparë me pikën 2 të kësaj thirrje publike;

5. Nuk subvencionohen

1. Qiraja për zyre, inventari, komunalitë, rekuizitat;
 2. Transferet e lojtarëve, rekuizitat sportive, pagat e lojtarëve, pagat e stafit.
 3. Klubet të cilat janë të regjistruara si OJQ në Komunën e Istogut, të cilat veprojnë në Republikën e Kosovës më pak se një vit para datës së publikimit të thirrjes publike.
 4. Kufizimet e parapara me rregulloren për subvencione në Komunën e Istogut.
6. Shuma për OJQ-të është 500 deri 13.000 Euro.
Duke u bazuar në bazë të numrit të aplikacioneve, mundësive financiare si dhe shpenzimeve që mbulohen tek kriteret e pranueshme sipas thirrjes.
Shuma totale e thirrjes deri në: 45.000 Euro.
7. Afati për dorëzimin e aplikimeve është prej 25.02.2026 deri më 11.03.2026 në orën: 16:00.
8. Periudha e zbatimit të projektit është deri me 31.12.2026
9. Propozimet duhet të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë në bazë të rregullores MF — Nr. 04/2017.
10. Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen personalisht ose me postë në zarf të mbyllur në zyrën e QSHQ (qendra për shërbim me qytetarë) në adresën: Komuna Istog, rruga Fadil Ferati, 31000. Procesi i pranimi, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënja e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në rregulloren për subvencione. Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë të pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.
11. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, por jo më vonë se tetë (8) ditë para mbylljes së thirrjes publike, duke shkruar në email: drin.sadikaj@rks-gov.net

Drejtor për Kulturë, Rinë dhe Sport
z.Genc Ademaj

